



Human Rights Review Panel

Buletini informativ # 12 – janar-prill 2015

- Seanca e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut
- Shkelja e të drejtave të njeriut në lëndën *X dhe 115 ankuesit e tjerë kundër EULEX-it*
- Nuk ka shkelje në dhjetë lëndë që kanë të bëjnë me keqtrajtimin e supozuar nga ana e policisë së Kosovës
- Vendime dhe komunikime të tjera
- Takime me shefin e zyrës për shtyp dhe informim publik i EULEX-it dhe komandën e policisë ekzekutive të EULEX-it
- Statistika të lëndëve

Dy seanca të Panelit

Seanca e parë e rregullt e vitit 2015 e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut është mbajtur në Prishtinë nga data 3 deri më 5 shkurt. Paneli ka gjetur tre lëndë të papranueshme. Paneli ka komunikuar një lëndë tek shefi i Misionit (ShM), duke e ftuar atë për që t'i ofroj vërejtjet mbi pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e saj.

Seanca e 25-të e rregullt e Panelit është mbajtur në Prishtinë nga 20-22 prill 2015. Paneli ka konstatuar një shkelje të të drejtave të ankuesit në një rast, ndërsa në një tjetër rast ka deklaruar se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut. Paneli ka shpallur pesë lëndë të tjera të papranueshme.

Seanca e ardhshme e Panelit është caktuar të mbahet në mesin e qershorit 2015.

Shkelja e të drejtave të njeriut në lëndën *X dhe 115 ankuesit e tjera kundër EULEX-it*

Paneli ka shqyrtuar lëndën e parashtruar nga 116 persona romë të zhvendosur brenda vendit (PZHBV), të cilët ishin zhvendosur gjatë konfliktit të vitit 1999 dhe vendosur në disa kampe të PZHBV-së (*X dhe 115 ankues të tjerë kundër EULEX-it, 2011-20*). Ankuesit kanë pretenduar se disa të drejta të tyre të njeriut janë shkelur gjatë ose si pasojë e qëndrimit të tyre në ato kampe. Në veçanti, ata kanë pohuar se iu janë nënshtruar rreziqeve të mëdha shëndetësore në këto kampe, ku ata ishin vendosur.

Në vendimin e tij të pranueshmërisë (të marrë më 5 tetor 2012), Paneli ka gjetur këtë ankesë të papranueshme në lidhje me akuzat për keqtrajtim dhe kushte joadekuate të jetesës në kampet e PZhBV-së. Këtë ankesë Paneli e ka shpallur të pranueshme në lidhje me dështimin e pretenduar të EULEX-it për të siguruar që ankuesit të kenë qasje në drejtësi, me qëllim të kërkimit dhe marrjes së një mjet efektiv juridik për shkeljen e të drejtave të tyre.

Në vendimin e datës 22 prill 2015 mbi meritat e lëndës, Paneli ka konstatuar se EULEX-i në Kosovë ka shkelur të drejtën e ankuesve në mjete efektive juridike të garantuar me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa). Paneli ka konsideruar se dështimi i EULEX-it për të iniciuar një hetim me kohë dhe në mënyrë efektive lidhur me shkeljet e pohuara të të drejtave të ankuesve ka rrezikuar mundësinë e tyre për të marrë një mjet efektiv juridik për dëmin që kishin pësuar. Paneli gjithashtu ka bërë rekomandime tek shefi i Misionit për masa korrigjuese. Paneli ka rekomanduar që ShM duhet të udhëzoj zyrtarët kompetentë të EULEX-it që të bëjnë një hetim me autoritetet e Kosovës se a është duke vazhduar ndonjë hetim mbi shkeljet e pohuara të të drejtave të ankuesve. Më tej, ShM duhet të udhëzoj prokurorët e EULEX-it që ta shqyrtojnë se a do ta marrin përsipër përgjegjësinë e kësaj lënde, posaçërisht marrë parasysh detyrimin e Misionit që të garantoj mbrojtjen efektive të të drejtave të ankuesve.

Nuk ka shkelje në dhjetë lëndë që kanë të bëjnë me dyshimin për keqtrajtim nga ana e policisë së Kosovës

Paneli ka shqyrtuar lëndët e paraqitura nga dhjetë qytetarë serbë, të cilët ishin arrestuar dhe gjoja rrahur nga policë të Policisë së Kosovës përderisa kanë qenë duke marrë pjesë në festimet e krishtlindjeve në manastirin e Graçanicës në vitin 2013 (*K,L,M,N,O,P,Q,R,S dhe T kundër EULEX-it*, nr. 2013-05 - 2013-14). Ankuesit kanë pohuar se EULEX-i kishte dështuar që t'i mbroj ata nga arrestimi arbitrar dhe keqtrajtimi prej Policisë së Kosovës. Në vendimin e tij, Paneli ka konstatuar se nuk ka pasur shkelje të të drejtave të ankuesve sipas nenit 3 të Konventës (kundër torturës, trajtimit mizor dhe poshtërues). Paneli konsideron se EULEX-i ka bërë gjithë çfarë mund të pritej të bëhet në ato rrethana për të siguruar që të drejtat e njeriut të ankuesve ishin respektuar dhe se situata për të cilën ka pasur ankesë nuk ka përbërë ndonjë shkelje të së drejtës së ankuesve që mund t'i atribuohet EULEX-it. Paneli gjithashtu ka vënë në dukje se keqtrajtimi për të cilën ka pasur ankesë ishte në procedurë e sipër pranë gjyqësorit të Kosovës.

Vendimet e papranueshmërisë

Gjatë sesionit të tij të parë për vitin 2015, Paneli ka gjetur tre lëndë të papranueshme. Njëri prej tyre kishte të bënte me procedurat të gjykatave të Kosovës (*Ajet Kaçiu kundër EULEX-it*, 2014-26). Si në shumë lëndë të mëparshme të ngjashme, Paneli ka deklaruar se në parim nuk kishte juridiksion t'i shqyrtuar procedurat gjyqësore të gjykatave të Kosovës, edhe në qoftë se gjykatësit e EULEX-it ishin pjesë e saj. Në dy lëndë të tjera, Paneli ka konstatuar se nuk ishte treguar se EULEX-i ka qenë i përfshirë në ndonjë cilësi në çështjet rreth të cilave ka pasur ankesë (*Qerim Begolli kundër EULEX-it*, 2014-27, *Shemsi Musa kundër EULEX-it*, 2014-29).

Pesë lëndë të tjera janë gjetur të papranueshme gjatë seancës së Panelit të mbajtur në prill. Në tre prej tyre, Paneli ka deklaruar se nuk kishte juridiksion për t'i shqyrtuar ato, pasi ato kishin të bënin me procedurat e gjykatave të Kosovës (*J.Q kundër EULEX-it*, 2014-24; *P.K kundër EULEX-it*, 2014-31, *Arben Krasniqi kundër EULEX-it*, 2014-33). Në një rast, Paneli ka konstatuar se nuk ishte treguar se ka pasur ndonjë përfshirje të EULEX-it në çështjet rreth të cilave ka pasur ankesë (*Adbij Sabani kundër EULEX-it*, 2014-30). Në një tjetër rast, Paneli ka gjetur ankesën të parakohshme, pasi që procedurat për të cilat kishte pasur ankesë ishin ende të pazgjedhura (*Mazlam Ibrahimimi kundër EULEX-it*, 2014-05).

Komunikimi i lëndëve tek shefi i Misionit të EULEX-it


Paneli i ka komunikuar një lëndë (*Y.B. kundër EULEX-it, 2014-37*) shefit të Misionit të EULEX-it, duke kërkuar nga ai që të ofroj vërejtjet e tij mbi pranueshmërinë dhe meritat e ankesës. Rasti ka të bëjë me shkeljen e pretenduar të të drejtave të ankuesit për jetë private (neni 8 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut) dhe parasupozimi i pafajësisë (neni 6 par. 2 i Konventës) nga një prokuror i EULEX-it.

Takimet me shefin e zyrës për shtyp dhe informim publik i EULEX-it dhe komandën e Policisë Ekzekutive të EULEX-it

Z. Roland Bless, shefi i ri i zyrës për shtyp dhe informim publik i EULEX-it (ZSHIP), është takua me Panelin më 20 prill 2015. Paneli ka informuar z. Bless rreth mandatit dhe veprimtarisë së vet dhe ka shprehur vlerësimin për mbështetjen e vazhdueshme dhe ndihmën e dhënë nga ZSHIP. Takimi gjithashtu ka qenë një mundësi për të diskutuar rreth bashkëpunimit të ardhshëm midis ZSHIP dhe Panelit në ngritjen e informimit dhe fushatën e informimit në media.

Një ditë më pas, Paneli është takuar me z. Alban Ragg, zëvendës shef i divizionit ekzekutiv të EULEX-it dhe shef i policisë ekzekutive, si dhe me komandën e policisë ekzekutive të EULEX-it. Pjesëmarrësit kanë diskutuar rreth çështjeve të të drejtave të njeriut dhe sfidat, të cilat zyrtarët e policisë së EULEX-it ballafaqohen në punën e tyre të përditshme. Ata gjithashtu kanë marrë në shqyrtim praktikën e punës së Panelit, e cila mund të jenë relevante dhe e dobishme për punën e policisë së EULEX-it.

Statistikat e lëndëve



Vizitoni faqen tonë të internetit: www.hrrp.eu



PARASHTRIMI I ANKESAVE

(Rregullat 25 dhe 26 të rregullores së punës të PShDNj-së)

Kush?

Çdo person i cili nuk punon për misionin e EULEX-it në Kosovë, i cili ankohet se ka qenë viktimë e shkeljes së të drejtave të njeriut nga ana e misionit të EULEX-it në Kosovë gjatë zbatimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Ankuesi (personi që e bën ankesën) mund të përfaqësohet nga ndonjë avokat ose përfaqësues tjetër sipas dëshirës së tij ose saj. Në këtë rast duhet të plotësohet autorizimi.

Çka?

Paneli do t'i shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me këto shkelje të dyshuara, të cilat kanë ndodhur në Kosovë pas datës 9 dhjetor 2008. Shkelja duhet të jetë shkaktuar nga misioni i EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit ekzekutiv të tij.

Paneli nuk do t'i shqyrtojë procedurat gjyqësore të kryera nga gjykatat në Kosovë.

Kur?

Ankesa duhet t'i parashtrohet Panelit brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar.

Si?

Ankesa duhet të parashtrohet me shkrim. Ankesa nuk mund të bëhet me telefon. Ankuesi mund ta përdorë gjuhën angleze, shqipe ose serbe. Normalisht, ankesa duhet të plotësohet në formularin përkatës dhe të shoqërohet me dokumente dhe vendime përkatëse (nëse ka), sipas udhëzimeve në formular.

Nëse ankesa paraqitet me anë të letrës, në të duhet të përcaktohet, të paktën në formë të përmbledhur, lënda e ankesës në mënyrë që ajo të shqyrtohet më tej.

Ku?

Ankesa mund të parashtrohet në:

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut - sekretariati

Rr. Rrustem Statovci nr. 29 – 10000 Prishtinë – Kosovë

Tel: +381 (0) 38 78 2125

Ankesa gjithashtu mund të parashtrohet përmes postës elektronike në: office@hrrp.eu

www.hrrp.eu

Plotësimi i formularit për ankesë

Ankesa duhet të shkruhet qartë dhe lexueshëm, dhe mundësisht të jetë e shtypur me kompjuter.

Formulari duhet t'i përfshijë të gjitha hollësitë kontaktuese të ankuesit.

Nëse ankesa përmban fakte të dokumentuara, duhet të paraqiten kopjet e lexueshme. **Mos i dërgoni dokumentet origjinale.**

Dokumentet duhet të renditen sipas datës dhe të shënohen me numra rendor të njëpasnjëshëm dhe me një përshkrim të shkurtër (p.sh. letër, urdhër, vendim, ankesë, etj.).

Ankesës i caktohet numri i dosjes. Numri i dosjes duhet të përmendet në të gjitha korrespondencat vijuese. Nëse ankuesi tashmë e ka një ankesë, e cila është duke u shqyrtuar nga Paneli, ai/ajo duhet ta informojë Panelin lidhur me numrin e dosjes së mëparshme. Nëse ankuesi për arsye të ndryshme nuk dëshiron që identiteti i tij/saj të bëhet publik, ai/ajo duhet ta plotësojë pjesën përkatëse në formularin e ankesës.